



**OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË TREGUT**

Nr. 6006 prot.

Tiranë, më 09.10.2020

Lënda: Raportim në lidhje me ecurinë e zbatimit të fazës Dry Run për implementimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.

**ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË**  
Bulevardi "Bajram Curri", Rruga "Viktor Eftimiu" nr.1023, Tiranë

**I nderuar Z. Ahmeti,**

Në vijim të vendimit të ERE, Nr.106, datë 02.07.2020 mbi miratimin e "Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike", në zbatim të pikës 5 të këtij vendimi ku citohet: "*Shoqëria "OST" sh.a., të raportojë dhe dokumentojë çdo muaj në lidhje me ecurinë e zbatimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike*", ju bëjmë me dije se në zbatim të vendimit të sipërcituar OST sh.a ka filluar implementimin e fazës Dry Run.

Implementimi i rregullave ka nisur me organizimin e workshop-it prezantues me pjesëmarrësit e tregut lidhur me organizimin dhe funksionimin e fazës Dry Run. Pjesëmarrësve të tregut iu vu fillimisht në dispozicion Manuali Udhëzues i cili ishte pjesë e diskutimit gjatë workshop-it. Materiali Udhëzues përmban një përshkrim të detajuar të mënyrës së organizimit dhe funksionimit të fazës Dry Run, lidhur me Regjistrimin, testimet dhe çdo proces tjetër të përfshirë në këtë fazë.

Për të qenë një ofrues i mundshëm Shërbimeve Balancuese, OSHB duhet të demonstrojë në OST sh.a nëse është në përputhje me kërkesat teknike dhe plotësuese të përcaktuara nga OST, duke kaluar me sukses procesin e parakualifikimit të njësisë të sigurimit të Shërbimeve Balancuese ose grupeve që ofrojnë Shërbime Balancuese.

Në përputhje me Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, OST sh.a me anë të komunikimit zyrtar u kërkoi përdoruesve potencial (njësitë siguruese të FCR/FRR/RR ose grupet siguruese të FCR/FRR/RR që konsiderohen të kenë rezervuarë të pakufizuar të energjisë për të ofruar sasinë e nevojshme të shërbimeve Balancuese) paraqitjen e informacionit mbi "Kriteret teknike të ofruesit të FCR/FRR/RR për vlerësimin fillestar të procesit të parakualifikimit.

Në përgjigje të shkresës së OST sh.a., Përdoruesit:

- Kurum International është përgjigjur me anë të shkresës 5102/1 datë 14.09.2020 duke përcjellë të dhënat e kërkuara nga OST.

- Korporata Energjetike Shqiptare është përgjigjur me anë të shkreses Nr.2589/1prot datë 25.09.2020 e protokolluar ne tonën Nr.5114/1 Prot datë 28.09.2020 duke përcjellë të dhënat e kërkuara nga OST.
- Ayen as Energji sh.a i është përgjigjur me anë të shkreses 5103/1 datë 22.09.2020 duke përcjellë të dhënat e kërkuara nga OST.
- Devoll Hydropower është përgjigjur me anë të shkreses protokolluar në tonën Nr. 5115/1 datë 01.10.2020 duke përcjellë të dhënat e kërkuara nga OST.

Në përputhje me Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjise Elektrike, OST sh.a i kërkoi edhe përdoruesit “Energji Ashta” SH.P.K paraqitjen e një informacioni mbi “Kriteret teknike të ofruesit të FCR/FRR/RR për vlerësimin fillestar të procesit të parakualifikimit. Në përgjigje të njoftimit të përcjell Përdoruesi “Energji Ashta” SH.P.K është përgjigjur me anë të emailit me datë 01.10.2020 se Hec-et Ashta 1 dhe Ashta 2 janë të tipit Run of River dhe teknikisht nuk mund të ofrojnë shërbime balancimi.

Grupi i punës në OST bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga Aplikuesit respektiv për t’u kualifikuar si Ofrues i Shërbimeve Balancuese pranoi listen e njësive teknike të përcjella nga kandidatët për t’u përdorur në ofrimin e shërbimit të balancimit. Të gjitha njësitë teknike në listë u vlerësuan të vecuara mbi të dhenat e përcjella. Pas vlerësimit të realizuar grupi i punës arriti në përfundimin se Aplikantët:

- Kurum International sh.a, kalon pjesërisht fazën e parakualifikimit teorit si OShB për periudhën Dry Run. Kualifikimi ishte i pjesshëm sepse HEC Ulez dhe Hec Shkopet ne vijim të parakualifikimit të kërkesave teknike duhet të vijoje me implementimet e nevojshme në sistemin SCADA për të mundësuar pjesëmarrjen në aFRR. Gjithashtu Përdoruesit i është bërë me dije se nëse nga ana e tij nuk merren masa për përmbushjen e detyrimeve për shkëmbimin e të dhënave në kohë reale deri në përfundim të DRY RUN, Kurum International sh.a automatikisht s’kualifikohet nga mundësia për të qenë OSHB. Komunikimi me këtë përdorues vijon intensivisht dhe nga ana e OST i është ofruar e gjithë konsulenca e nevojshme.
- Ayen as Energji sh.a, kalon me sukses fazën e parakualifikimit si OShB për periudhën Dry Run Rezultati për secilën njësi është realizuar bazuar në të dhënat teknike të çdo njësie sipas informacionit që Përdoruesi ka përcjelle.
- KESH sh.a, kalon me sukses fazën e parakualifikimit si OShB për periudhën Dry Run Rezultati për secilën njësi është realizuar bazuar në të dhënat teknike të çdo njësie sipas informacionit që Përdoruesi ka përcjelle
- Devoll Hydropower sh.a kalon me sukses fazën e parakualifikimit si OShB për periudhën Dry Run vetëm për Hec Banjë. Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit përkatës, lidhur me kualifikimin për [aFRR] Hec Moglicë kalon pjesërisht (me kushtin që të dhënat do vërtetohen dhe saktësohen përpara përfundimit të procesit të DRY RUN). Hec Moglica në vijim të parakualifikimit të kërkesave teknike duhet të vijoje me implementimet e nevojshme për të mundësuar pjesëmarrjen në aFRR. Kjo procedurë duhet të përfundoj sa më shpejt të jetë e mundur

Për sa më lart në lidhje me parakualifikimin e kërkesave teknike të përfunduar tashmë, theksojmë se ky përfundim ka vlerë vetëm për fazën e DRY RUN.

Në njoftimet e kualifikimit për fazën DRY RUN që OST sh.a i ka përcjellë OSHB (DRY RUN) ju ka kërkuar se duhet të përcaktojnë periudhën e përshtatshme që OST sh.a të realizojë testimet për parakualifikimin përfundimtar. Gjatë këtij afati OSHB (DRY RUN) duhet të kenë realizuar çdo proces pune në objektin e tij, i cili është i domosdoshëm për mbarëvajtjen e funksionimit të Tregut Balancues.

Po vijon procesi i regjistrimit të pjesëmarrësve të tregut në tregun balancues për fazën Dry Run si PPB dhe OSHB (subjektet e parakualifikuara). Njëkohësisht janë identifikuar çështje që do të rishikohen në vijim në rregullat e tregut balancues para hyrjes në operim të tregut lidhur me procedurën dhe formularët e regjistrimit. Prosesi i regjistrimit është kryer në përputhje me procedurën e regjistrimit në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit dhe deri më tani Pjesëmarrësit nuk kanë hasur vështirësi në plotësimin e dokumentacionit. Ky proces pritet të përfundojë javën që vjen.

Po punohet me skenaret e testeve që do aplikohen në bashkëpunim me pjesëmarrësit e tregut për operimin e tregut balancues.

Me respekt,

**ADMINISTRATORI I OST SH.A.**

